



OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Drejtuar:

OE “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k. me NIPT J72124001N
Tiranë, Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km-10.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me mjete elektronike – Mallra.

Numri i referencës së procedures: REF-95517-02-15-2024.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Tonera dhe aksesore për pajisje printimi multifunksionale”.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 09, datë 19.02.2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1. OE “InfoSoft Office” sh.p.k. me NIPT J62426002Q**
Vlera 1,486,197 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH.
- 2. OE “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k. me NIPT J72124001N**
Vlera 1,581,361 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) Lekë pa TVSH.
- 3. OE “Adenis Kastrati” p.f. me NIPT L51611004I**
Vlera 1,995,000 (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) Lekë pa TVSH.
- 4. OE “Microtech Computer Systems” sh.p.k. me NIPT M21517046I**
Vlera 3,314,500 (tre milion e treqind e katërbëdhjetë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE “InfoSoft Office” sh.p.k., me NIPT J62426002Q, për arsye se:

Oferta refuzohet, në zbatim të pikës 3, të nenit 82, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për shkak se shumta absolute e të gjithë korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

2. OE “Adenis Kastrati” p.f., me NIPT L51611004I, për shkak se:

Nuk ka përmbushur pikën 2.2.1, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur kopje të certifikuara të bilanceve, për të vërtetuar se në të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, sipas parashikimeve të nenit 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.4, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur produktet e kërkuara në formë katalogu me të dhënave teknike të ofruara të produkteve objekt prokurimi, sipas kërkesës së DST.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.6, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur nga një mostër të artikujve të kërkuar.

3. OE “Microtech Computer Systems” sh.p.k., me NIPT M21517046I, për arsye se:

Oferta e paraqitur nga OE, është më e lartë se fondi limit, i përlogaritur për këtë procedurë.

Nuk ka përmbushur pikën 2.2.1, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur vërtetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore, si dhe kopje të certifikuara të bilanceve, për të vërtetuar se në të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, sipas parashikimeve të nenit 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.1, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur kontrata të ngjashme në vlerën e kërkuar. Faturat e paraqitura arrijnë në vlerën prej 163,400 Lekë pa TVSH, ndërkohë që është kërkuar që OE ofertues të ketë kontrata të ngjashme në vlerën 450,000 Lekë pa TVSH.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.3, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur certifikatën ISO 14001:, sipas kërkesës së DST.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.4, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur produktet e kërkuara në formë katalogu me të dhënave teknike të ofruara të produkteve objekt prokurimi, sipas kërkesës së DST.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.5, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur një deklaratë ku të cilësojë se mallrat e ofruara, janë origjinale, jo kompatibël apo të rimbushura.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.6, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur nga një mostër të artikujve të kërkuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k., me NIPT J72124001N**, Adresa: Tiranë, Kashar, Autosrada Tiranë-Durrës, Km.10, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **1,581,361 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.